

SYLLABUS

Të dhëna bazike të lëndës				
Njësia akademike:		Fakulteti i Menaxhmentit		
Programi:		Menaxhimi i Biznesit dhe Ndërmarrësia		
Titulli i lëndës:		Matematika për Biznese		
Niveli:		Baçelor		
Statusi i lëndës:		Obligative		
Viti i studimeve:		I		
Semestri:		I		
Numri orëve në javë:		3		
Vlera në kredi – ECTS:		6		
Koha / lokacioni:		USHAF		
Mësimdhënësi i lëndës:				
Detajet kontaktuese:				
Përshkrimi i lëndës		Kuptimet themelore për bashkësitë dhe veprimet me bashkësi, Bashkësia e numrave realë dhe veprimet me numra realë, Elementet e algjebërës lineare (ekuacioni i drejtëzës së buxhetit), Përcaktorët, Matricat dhe sistemet e ekuacioneve lineare, Kuptimi i funksionit dhe aplikimi i tij, Funksionet elementare dhe grafiku i tyre, Vargjet numerike dhe aplikimi i tyre, Limiti i vargut dhe i funksionit, Vazhdueshmëria e funksionit, Derivati i funksionit dhe zbatimi i tij, Elementet e matematikës financiare.		
Qëllimet e lëndës		Qëllimi i këtij moduli është për të pajisur studentët me njohuri dhe aftësi për kuptimet themelore matematikore, elementet e matematikës financiare, kuptimin e funksionit, mënyra të dhënjes së funksionit, disa klasë funksionesh, kuptimin e matricave, derivatit, etj. Si dhe qëllimi kryesor është zbatimi i tyre në fushën e biznesit dhe ekonomisë (fushën e studimit të tyre), pra zhvillimi i shkathtësive dhe aftësive të studentëve për të zgjidhur problemet konkrete të fushës ekonomike.		
Rezultatet e pritura të mësim-nxënies		Pas përfundimit të kësaj lënde studentët do të: 1. Të kenë njohuri themelore konceptuale për rëndësinë e lëndës së Matematikës në biznes, (ECTS 1.5) 2. Të njohin dhe të kuptojnë elementet e algjebërës lineare në zgjidhjen e problemeve nga fusha e biznesit (ECTS 1.5) 3. Të përvetësojnë elementet e matematikës financiare. (ECTS 1.5) 4. Të njohin konceptin e vargut dhe funksionit, llojeve të funksioneve, vetitë dhe zbatimet e tyre. Zbatimi i tyre në ekonomi. (ECTS 1.5)		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)				
Aktiviteti		Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata		2	15	30

Ushtrimet teorike/detyra	1	15	15
Punë/Vizitë praktike	5	1	5
Kontaktet me mësimdhënësit – konsultimet	1	10	10
Përgatitja për detyra projekte	1	5	5
Projekt kursi – Test (planifikim + zbatim)	2	2	4
Detyra të shtëpisë	2	10	20
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			30
Përgatitja përfundimtare në provim	2	10	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	2	3	6
Projektet, prezantimet etj	1	5	5
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies dhe mësim-nxënies	Kursi zgjat 15 javë me 2 orë ligjerata dhe 1 orë ushtrime javore individuale dhe grupore. Ushtrimet do të mbahen në formën e punës individuale dhe grupore në të cilën do të diskutohen shembuj konkretë. Pjesëmarrja aktive është jashtëzakonisht e rëndësishme, kështu që studentët inkurajohen që të ndjekin rregullisht leksione dhe ushtrime dhe të kontribuojnë në diskutimet që zhvillohen në leksione. Ligjerata, punë individuale, diskutime dhe punë grupore..		
Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë	Metoda e vlerësimit – mbështetet në tri aktivitete – në baze të të cilave do të ndërtohet nota përfundimtare: ➤ Aktivitet dhe Angazhim në mësim.....max 10 pikë (%), ➤ Provimi final (ose nga dy teste).....max 90 pikë (%), Kriteret e kalueshmërisë - ndërlidhur me aktivitetet e parapara me metodën e vlerësimit: 1. Aktiviteti dhe Angazhimi në mësim – vlerësohet me 10 pikë (%) nga 100 pikët (%) e mundshme: • Aktiviteti në mësim (5 pikë (%)) - nënkupton që studenti të jetë aktive dhe i përfshirë në diskutime interaktive profesor-studentë, studentë-studentë, duke hapur tema të reja që janë të ndërlidhura me lëndën, duke dhënë ide, opinione, mendime kritike me qëllim të nxitjes së debatit gjatë ligjëratave. • Angazhimi (5 pikë (%)) - nënkupton që studenti të kryejë dhe prezantojë detyrat që caktohen në fund të secilës ligjëratë dhe pastaj diskutohen në fillim të ligjëratës vijuese. 2. Testi i provimit final, vlerësohet me 90 pikë (%) nga 100 pikët (%) e mundshme, Brenda semestrit parashihet të mbahen dy Teste (2 x 45 pikë (%)) për studentët e angazhuar aktiv me pjesëmarrje në ligjëratat, testi i parë në javën e 7 ose të 8 dhe testi i dytë në fund të ligjëratave, studenti e kalon testin nëse ka min 22 pikë (%), pasi që studenti vlerësohet se ka kaluar testin e parë, atëherë studenti mund t'i nënshtrohet testit të dytë studenti ka të drejtë të nënshtrohet drejtpërdrejt provimit final - me gojë ose me shkrim. Studenti do t'i nënshtrohet testit të provimit final, pas përfundimit të ligjëratave të lëndës dhe në afatet e provimeve të përcaktuara nga senati i Universitetit.		

	Testi i provimit (formulari me pyetje) duhet te plotësohet në mënyrë individuale nga studenti dhe i njëjti vlerësohet sipas kriterëve dhe përmban: ♦ pyetje objektive, të njëjtat do të shfrytëzohen për të vlerësuar aftësitë e studentit për të ri- kujtuar dhe njohur konceptet dhe materialin e lëndës.....40 pikë (%), ♦ pyetje me detyra - për të cilat vet studenti duhet të jete në gjendje të jep përgjigje me zgjedhje te detyrave....50 pikë (%) Qëllimi i testit: të vlerësojë përvetësimin e rezultateve te mësim-nxënies dhe aftësinë për t'i zbatuar ato në situata praktike. Studenti e kalon provimin nëse grumbullon 50 pikë (%) nga të gjitha aktivitetet e parapara me metodën e vlerësimit, Notat në UShAF: <table><tr><th>Nota</th><th>ECTS/Nota</th><th>Përqindja (%)</th><th>Përkufizimi</th></tr><tr><td>10</td><td>A</td><td>90 - 100</td><td>Shkëlqyeshëm</td></tr><tr><td>9</td><td>B</td><td>80 - 89</td><td>Shkëlqyeshëm</td></tr><tr><td>8</td><td>C</td><td>70 - 79</td><td>Shumë mirë</td></tr><tr><td>7</td><td>D</td><td>60 - 69</td><td>Mirë</td></tr><tr><td>6</td><td>E</td><td>50 - 59</td><td>Mjaftueshëm</td></tr><tr><td>5</td><td>FX/F</td><td>0 - 49</td><td>Pamjaftueshëm</td></tr></table>	Nota	ECTS/Nota	Përqindja (%)	Përkufizimi	10	A	90 - 100	Shkëlqyeshëm	9	B	80 - 89	Shkëlqyeshëm	8	C	70 - 79	Shumë mirë	7	D	60 - 69	Mirë	6	E	50 - 59	Mjaftueshëm	5	FX/F	0 - 49	Pamjaftueshëm
Nota	ECTS/Nota	Përqindja (%)	Përkufizimi																										
10	A	90 - 100	Shkëlqyeshëm																										
9	B	80 - 89	Shkëlqyeshëm																										
8	C	70 - 79	Shumë mirë																										
7	D	60 - 69	Mirë																										
6	E	50 - 59	Mjaftueshëm																										
5	FX/F	0 - 49	Pamjaftueshëm																										
Mjetet e konkretizimit – TI	Përdorimi Tabela inteligjente, Interneti, wireless, kompjuteri, projektori, PowerPoint, Përdorimi i platformave dhe mjeteve “on-line” për të mbështetur komunikimin dhe bashkëpunimin në ekip, etj.																												
Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit	50% - Teori, 50% - Ushtrime/detyra praktike, Ky raport ka për qëllim të analizojë lidhjen ndërmjet njohurive teorike të përfituara gjatë ligjëratave të parapara në modulin e lëndës dhe realizimit të ushtrimeve praktike (zgjidhje te detyrave, ushtrime me studentë, kuize studentore në klase, etj). Nga gjithsej 150 orë të parapara për lëndën, ndarja është bërë sipas raportit 50% me fokus në teori dhe 50% në ushtrime/detyra praktike. • 75 orë janë të dedikuara për ligjërata teorike, përfshirë përvetësimin e koncepteve bazë, metodologjive dhe standardeve të parapara ne modulin e lëndës. • 75 orë janë të fokusuara në ushtrime/detyra praktike, analiza rastesh konkrete, punë në grup dhe zhvillim projektsh simulimi. Ndarja e 6 ECTS sipas raportit 70%-30% ❖ 3 ECTS - i dedikohen pjesës teorike, ❖ 3 ECTS - i dedikohen pjesës ushtrime/detyra praktike, Kjo ndarje reflekton balancën ndërmjet përvetësimit të koncepteve bazë dhe zbatimit të tyre përmes aktiviteteve praktike.																												
Literatura																													
Literatura bazë	1. N.L. Braha, V. Loku dhe Ilmi Hoxha, Matematika për ekonomistë, 2016, Prishtinë. 2. Ian Jacques-Mathematics,for economics and business, ninth edition, 2018,																												

Literatura shtesë	1. Dr.Sc.Razim Hoxha, Përmbledhje detyrash të zgjidhura nga matematika I, Prishtinë-2011,
<u>Informacion shtesë</u>	
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë	Bashkësitë, bashkësitë numerike dhe veprimet me to Ne këtë ligjëratë epen kuptimet themelore në lidhje me bashkësitë dhe veprimet me to, me pas merren bashkësitë numerike si ajo e numrave natyral, të plotë, racional dhe real
Java e dytë	Funksionet elementare dhe vetitë e tyre Ne këtë ligjëratë epen kuptimet themelore të funksioneve lineare, kuadrato, eksponenciale, logaritmike, trigonometrike dhe grafiket e tyre.
Java e tretë	Matricat dhe përcaktorët Ne këtë ligjëratë epen kuptimet dhe veprimet me matrica dhe përcaktore.
Java e katërt	Sistemet e ekuacioneve lineare Ne këtë ligjëratë epen kuptimet dhe zgjidhjet e sistemeve të ekuacioneve lineare, si dhe metodat e zgjidhjes së tyre.
Java e pestë	Kuptimi i vargut numerike dhe vetitë e tyre Ne këtë ligjëratë epen kuptimet e vargjeve numerike, vargut aritmetike, vargut gjeometrik, zbatime të tyre dhe vetitë si monotonia dhe kufizueshmëria.
Java e gjashtë	Limitet e vargjeve numerike dhe vargu i numrit e Ne këtë ligjëratë epen limitin e vargjeve dhe vetitë e tyre, me pas merret përkufizimi i numrit dhe zbatimi i tyre.
Java e shtatë	Vetitë e funksioneve Ne këtë ligjëratë merren vetitë bazike të funksioneve, domenet e funksionit, monotonia, kufizueshmëria, perioda e funksionit, etj.
Java e tetë	Limiti i funksionit Ne këtë ligjëratë epen kuptimin e limitit të funksionit si në rastin algjebrik ashtu edhe në atë trigonometrike dhe shqyrtohen format e pacaktuara të tyre. Parashihet të organizohet Testi i parë.
Java e nëntë	Vazhdueshmëria e funksionit Ne këtë ligjëratë epen kuptimet themelore në lidhje me funksione të vazhdueshme dhe epen disa veti të tyre me zbatime
Java e dhjetë	Kuptimi i derivatit të funksionit Ne këtë ligjëratë epen kuptimin e derivatit të funksionit përmes shembullit të tangjentës së grafikut të funksionit. Me pas vetitë themelore të tyre, si dhe derivatet e funksioneve të përbëra.

Java e njëmbëdhjetë	Zbatime te derivative Ne këtë ligjëratë merren disa zbatime te derivateve te funksioneve si paraqitja grafike e funksioneve përmes te derivatit, me pas problem praktike ne vlerat maksimale dhe minimale e te tjera
Java e dymbëdhjetë	Zbatime te derivateve ne ekonomi, modeli makroekonomik i Keysit Ne këtë ligjëratë epet modeli themelore i modelit makroekonomik te Keysit, ne te cilin nuk merren parasysh ndihma e shtetit dhe te faktorët e jashtëm.
Java e trembëdhjetë	Interesi i thjeshte dhe i përberë Ne këtë ligjëratë epen kuptimet dhe zbatimet e interesit te thjeshte dhe te përberë dhe merren probleme konkrete te shqyrtimit te tyre.
Java e katërbëdhjetë	Anuitetet Ne këtë ligjëratë epen kuptimet themelore te anuiteteve dhe zbatimet e tyre ne praktike.
Java e pesëmbëdhjetë	Huaja Ne këtë ligjëratë epen kuptimet themelore te huase, amortizimi i saj dhe zbatimet e tyre ne praktike. Parashihet te organizohet Testi i dytë,
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes	
Studenti është i obliguar t'i vijojë ligjëratat më rregull dhe të ketë sjellje korrekte nda j kolegëve dhe stafit të Universitetit, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në ligjëratat dhe ushtrime është e obligueshme. Gjatë orëve të ligjëratave dhe ushtrimeve NDALOHET ushqimi, pëshpërimat që pengon punën në klasë dhe përdorimi i telefonave mobil. Njëkohësisht, telefonat celularë duhet të fiken ose të vihen në heshtje dhe të mos përdoren gjatë kohës së ligjëratave apo ushtrimeve. Mungesa e integritetit akademik (ku përfshihet plagjiatura, kopjimi i punës së një personi tjetër, përdorimi i ndihmave të paautorizuara në provime, mashtrimi etj) nuk do të tolerohet. Nëse ka dyshime për vërtetësinë e punës së paraqitur, mësimmndhënësi ka të drejtë t'i kërkoj studentit të verifikojë punën e tij/saj. Kjo mund të bëhet përmes: përsëritjes së punës, testimit me shkrim ose me gojë, kuiz i papritur apo me çdo veprim tjetër që konsiderohet i nevojshëm nga ligjëruesi.	